



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KUVENDI I KOMUNËS

01 Nr. 060/01-23650/2022

Datë.19.10.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e nëntë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2022 e mbajtur me dt.26.10.2022, me fillim në orën 10.00, në sallën Solemne të Pallatit të Kulturës rruga UÇK Gjakovë.

Mbledhjen e kryesoi : znj. Arbënesha Kuqi , Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës .

Në mbledhje marrin pjesë 33 anëtarë të Kuvendit të Komunës: z. Agustin Shala, znj. Albina Sadrija, znj. Teuta Pallaska Milla, z. Nik Hiseni, z. Hekuran Hoxha z. Valon Pnishi, znj. Ermira Mehmeti, znj. Albulena Zuka, z. Besim Kadrija z. Ngadhnjim Dana, znj. Mimoza Shala, z. Mustafa Domi, znj. Diana Qarkaxhija z. Ali Tafarshiku, z. Kreshnik Alijaj, z. Ledian Rexha, znj. Shqipe Fejza z. Agon Dobruna, z. Ermal Kusari, z. Bashkim Gashaj, z. Liridon Dula, znj. Lirianda Dahsyla, z. Teki Shala, z. Nexhdet Morina, znj. Saranda Hoda, znj. Besarta Lekaj, z. Besim Ndau, z. Ardian Nushi, znj. Lerena Kameraj, znj. Krenare Bushaj, z. Fazli Hoxha.

Mungon: z. Him Zeqa, zn. Ngadhnjim Dana , me arsye

Të pranishëm të tjerë: Kryetari i Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini Nënkryetari z. Flamur Fetahaj, Drejtor të Drejtorive Komunale, përfaqësues të Mediave të OJQ-ve, të OSBE, qytetar të Komunës së Gjakovës, zyrtarët për informim, zyrtarë të tjerë Komunal.

Kryesuesja: I nderuar Kryetari i Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini, Nënkryetari z. Flamur Fetahaj të nderuar anëtarë të pranishëm të Kuvendit të Komunës, të nderuar drejtor të drejtorive Komunale, përfaqësues të mediave, të OSBE, zyrtar komunal të nderuar të pranishëm.

Sot e kemi mbledhjen e nëntë të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2022, Materialin dhe ftesën për këtë mbledhje ju kemi shpërndarë sipas afateve të parapara ligjore, të papranishëm janë 33 anëtarë, dy kane njoftuar se nuk marrin pjesë ne mblidhej, meqenëse ekziston Koriumi po fillojmë me mbledhjen, fillimisht po ju propozoj që t[] kemi edhe 4 pika shtesë për këtë mbledhje e që janë : **1.** Propozim Vendimi për Ndryshimin e vendimit 01.nr.011-49415 i datës 25.11.2016 **2.** Rishikimi i Vendimit 01 nr.011/01-21906 i datës 28.09.2022 për caktimin e Lokacionit për ndërtimin e Qendrës Ditore për Pensionistë në Komunën e Gjakovës **3.** Rishikimi i Rregullores 01 nr.110/04-21913 e datës 28.09.2022 për Taksa komunale ku nga Ministra e Shëndetësisë është rekomanduar që të heken nga tabela disa nga pikat e bashkëfinancimit siç janë pika 8,14,24,27,28,29, të nenit 35 të rregullores, **4.** Rishikimi i vendimit 01nr011/01-21911 i datës 30.09.2022 për mbështetje Financiare të Shoqatës Handikos të andaj propozoj që të hyjnë këto pika në këtë rend dite .

E Qes në Votim Miratimin e Rendit të Ditës sipas Ftesës që e keni marrë me këto 4 pika shtesë , pika për ndryshimin e vendimi të duhet të diskutohet në pikën 3 ndërsa tjerat sipas renditjes para pikës të ndryshme .Kush Është : Për, Kundër, Abstenim

Nga anëtarët e pranishëm unanimisht u votua pro rendit të ditës.

Pas votimit te bërë u miratua ky :

RENDI I DITËS

1. Pyetje për ekzekutivin nga anëtarët e Kuvendit.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Marrëveshjes së Binjakëzimit Gjakovë – Shkodër.
3. Propozim Vendimi për Ndryshimin e vendimit 01.nr.011-49415 i datës 25.11.2016 .
4. Propozim - Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale me numër të njërive kadastrale 4501-38 dhe 4501-38-30-0 Z.K- Gjakovë.
5. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit nr. 01-011-78400 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale “ Tregu në Orize”.
6. Miratimi i Buxhetit Suplementar për vitin aktual 2022
7. Shqyrtimi i informatës së tretë periodike financiare Janar – Shator 2022.
8. Shqyrtimi i informatës mbi implementimin e Planit për Investime Publike Janar – Shtator 2022.
9. Shqyrtimi i informatës mbi implementimin e Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave 2021-2025.
10. Shqyrtimi i raportit vjetor Financiar i Ndërmarrjes K.R.M “ Çabrati” për vitin fiskal 2021.
11. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Ndërmarrjes Publike Lokale NP “ Ngrohtorja e Qytetit” për vitin fiskal 2021.
12. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i N.P.L “Stacioni i Autobusëve” SH.A për vitin fiskal 2021.
13. Rishikimi i Vendimit 01 nr.011/01-21906 i datës 28.09.2022 për caktimin e Lokacionit për ndërtimin e Qendrës Ditore për Pensionistë në Komunën e Gjakovës .
14. Rishikimi i Rregullores 01 nr.110/04-21913 e datës 28.09.2022 për Taksa komunale .
15. Rishikimi i vendimit 01nr011/01-21911 i datës 30.09.2022 për mbështetje Financiare të Shoqatës Handikos
16. Të ndryshme.

1.Pika e parë e rendit të ditës: Pyetje për ekzekutivin nga anëtarët e kuvendit.

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Pyetje për ekzekutivin nga anëtarët e kuvendit, andaj e hapi diskutimin për këtë pikë .

z. Ledian Rexha : Pyetja ime ka të bëjë me mungesën e pajisjeve për fotografimin e dhëmbëve ne QKMF, mjeket e kane obligim qe para se me e fillua trajtimin apo shërimin e dhëmbit te qytetareve te kërkojnë fotografimin e dhëmbit dhe ky shërbim nëpër QKMF tona nuk kryhet dhe qytetaret janë te detyruar me shkua ne klinika private me i marr këto shërbime andaj ne si Lëvizje vetëvendosje kërkojmë qe këto shërbime te kryhen ne qendra tona te Mjekësisë Familjare , AMF kur ka ndërprerje t rrymës janë te detyruar ti mbyllin qendrat ne mungesë te gjeneratorëve . Teatri ka 8 muaj qe nuk është duke punuar dhe ku qëndron problemi pse nuk punon . Ministria e Kulturës ka kërkuar që të hartohet strategjia 3 vjeçare e punës andaj deri ku ka arritur teatri jonë me këtë çështje, Për Klubin Furbollistik Vllaznimi edhe ne gjendej te mjerueshëm andaj po kërkoj se çka ka ndërmarr komuna për me i ndihmua këtij klubi me dal nga kjo gjendje .

znj. Diana Qarkagjija: Ne mbledhjen e kaluar kame kërkuar nga Drejtoresha e DKA-s dhe ende nuk kamë marr përgjigjeje edhe pse kanë kaluar 4 javë.

Z. Teki Shala: A ka ndonjë veprim konkret për përgatitjen e projektit për urën ne Rugovë sepse nuk po e vërejmë se ka ndonjë lëvizja, si dhe ka kohë që është nënshkruar një marrëveshjeje me Fakultetin e ndërtimtarisë për vlerësimin e rrezikshmërisë së kalimin ne ketë ure dhe ende nuk kemi mare asnjë raport .

z. Kreshnik Alijaj: Shqetësimi ime është lidhur me rrugën nga Gjykata e deri ne Dardani si ka mundësi komuna me e lanë at rrugë ne atë gjendje qe po shkakton shumë telashe për qytetaret edhe rrugët dytësore nuk mirëmbahen , ne Dardani nuk ka trotuare nuk ka Ndriçim . Për Ndriçimin publik qe 6 muaj kam ber kërkesë dhe ende nuk ka ndodh asnjë gjë nga ajo kohë dhe problem tjetër eshët se janë disa fshatra qe 24 or nuk ndalët ndriçimi edhe për ketë nuk është marr as një veprim .

znj. Mimoza Shala : Unë dua t ngriti problemin me qentë endacak a e keni mëndu ndonjë plan për zgjedhjen këtij problemi. çështja tjetër është me dhënë ne shfrytëzim te pronës komunale e kam fjalën për tregun ne Rogov qe nuk i përmbush detyrimet qe i ka me kontratë për mirëmbajtje dhe për gjelbërim e trotuare e te ngjashme kështu qe a ka mëndu komuna qe te kërkoj zbatimin e kontratës.

z. Ali TAFarshiku: Ne bllokun e ri funksionojnë disa biznese por kemi pengesa ne trotuar si pasoj e mungesës se parkingjeve andaj kur do te lirohen ato trotuare, Për rrugën për ne fshatin Jahoc kemi ankesa lidhur me hedhjen e mbetjeve shtazore qe e rrezikojnë edhe qarkullimin e njerëzve dhe mungon rrejtja e ndriçimit publik . A mendon Komuna e Gjakovës për rivlerësimin e rasteve sociale sipas planit për Banim Social. Kush është mpiksurës i Punimeve ne Ndërtesën e re te Komunës sepse kemi pasur disa ankesa nga profesionistet lidhur me vendosjen e tullave te jashtme , andaj a janë ne kudër te projektit ato tulla.

znj. Shqipe Fejza: Pyetja ime është për drejtorinë Kulturës sepse Klubi i Basketbollit Vllaznimi kam dëgjuar se i merr karriget me qera kur kane ndeshjeje pse ndodhe kjo , Pyetja tjetër ka te bej me shenjat e trafikut sepse janë te dëmtuara dhe janë te shtrira ne tok , unë kame kërkuar nga muaj Gusht dhe ende nuk janë kryer këto renovime te shenjave pse po ndodh kjo vonës.

Kryesuesja : Falënderoj te gjitha ata qe ju kanë bashkangjitur aksionit për solidarizimin me muajin Rozë për parandalimin e Kancerit te gjirit .

Kryetari: Për çështjen e grafive dentare nuk e di por do te interesohemi , gjeneratorët për një kohe nuk kanë funksionuar por do te rregullojmë ketë çështje, për Teatër arsyet pse nuk punojnë janë arsye te tyre sepse i kanë te gjitha mundësit për me punua por ata janë përgjegjës ne nuk mundemi me ndërhy, Për Klubin Futbollistik Vllaznimi është OJQ dhe ne e kemi provuar qe te ju ndihmojmë me ndihmë financiare dhe ju kemi dhënë mjete sa te gjitha klubeve tjera , ju kemi ndërtua fushën ndihmesë, jemi duke e financua nderimin e Sdadjonit , po te kisha vendos unë do te kisha dërguar drejt formimit te shoqërisë aksionare ose edhe e kisha privatizua sepse nga praktika vetëm klubet qe kanë titullar te pastër po kanë suksese dhe mire menaxhohen . zyre informatë e kërkuara për parashkollorët duhet me ti përcjell dhe do te kërkojë ti përcjellin , Unë kam kruar edhe publikisht për me u angazhua për urën ne Rogov por nuk kemi ende përgjigjeje konkretë se a e buxhetojm ne hartimin e projekti dhe përgjigjja ka qen se kryen ministria dhe ende nuk kemi konkretisht , për marrëveshjen me Universitetin jemi duke prit me i dërgua rezultatet , Për daljen për Pejë ke te drejtë dhe lajmi i mire reshte se sot do te fillojnë punimet për daljen për Peje, ndërsa për pjesën deri te zjarrfikësit do te sanohet ne ketë vit sepse nuk do te fillojmë ne rrenim ne ketë vit . Për ndriçimin publik jemi duke punuar dhe do te përfundime me te gjitha vendet . Aty ku nuk ndalet ndriçimi ka keqpërdorim dhe dëmtim te rrjetit te ndriçimit andaj kërkoj nga këtu qe Shërbimet Publike me polici te dalin ne teren , për qenet endacak e kemi tenderin për trajtimin e tyre dhe jemi e vetmja komuna qe jemi duke punuar me ketë drejtomë për ndërtimin e strehimoreve nuk na është lejua nga ministria. Për dhënin e pronës ne shfrytëzim jemi duke i përcjellë kontratat dhe do te shkëpusim ato kontrata për ata qe nuk po ju përmbahen pra për disa nga ato jemi duke i punuar vendimet për shkëputjen e tyre nuk do te lejojmë te ketë abuzim me pronat komunale. Për trotuaret ene Bllokun e ri Kompania ja ka fillua me punua për nderimin trotuareve deh parkingjeve, për rrugën për Jahoc kërkoj nga inspektorët qe te dalin menjëherë ne teren dhe kërkoj edhe nga qytetaret qe ta njoftojnë për këto raste , për banimin social duhet te behet rivlerësimi dhe duhet te shikohen kushtet për ata qe i shfrytëzojnë, për ndarësen e re e komunës mbikëqyrësi është nga bashkimi evropian , materiali i tullave edhe aprovuar edhe ne Bruksel është ne bazë te kontratës, për karriget ne Pallatin e sportit do te shikojmë pse është kështu, pre shenjat e trafikut kemi pasur vonës me kontratë tani e kemi kontratën aktive dhe do te punojmë ne shenjzim.

z. Shkumbim Kastrati: Tregu ne Rogove ka kontratë 10 vjeçare dhe nëse nuk veprohet sipas kontratës do te veprojmë sipas procedurave ligjore, Ndriçimi Publik u përgjigj kryetari , për trajtimin e qeneve Endacak ne kuadër te Asociacionit te Komunave jemi duke punuar ne hartimin një Udhëzimi administrativ për trajtimin e qeneve endacak

2. Pika e dytë e rendit të ditës : Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi dhe miratimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit Ndërkombëtar Gjakovë – Shkodër, ashtu siç jemi në dijeni ne i kemi ndjekur të gjitha procedurat e parapara ligjore për bashkëpunim Ndërkombëtar ku kemi miratuar nismën për Bashkëpunim ndërkombëtar me Bashkinë e Shkodrës Republika e Shqipërisë, dhe e kemi autorizuar Kryetarin e Komunës që të vazhdoj procedurat për nënshkrimin e marrëveshjes së Bashkëpunimit, tani janë ndjekur proceduara dhe është nënshkruar marrëveshja në mes të dy kryetareve dhe sipas procedurave Ligjore nevojitet që të miratohet kjo marrëveshje në Kuvendit e Komunës , ku edhe ju kemi prezantuar këtu për shqyrtim dhe miratim, Kërkoj nga të gjitha personat përgjegjës në fushat e përpara për bashkëpunim në këtë marrëveshje që të angazhohen seriozisht që kjo marrëveshje mos të mbetet vetëm në letër por të jetësohet sepse është vullneti dhe interesi i dy anshme që të jetësohet kjo marrëveshje, prezent është edhe Kryetari i Komunës nëse kërkohet ndonjë sqarim .

Kryetari : Kjo është procedurë ligjore te cilët duhet te kalojmë ligji e parasheh se Kuvendit e miraton Nismën për Bashkëpunim Nder komunal Ndërkombëtar dhe jam autorizuar unë si Kryetar i Komunës qe te lidhe dhe nënshkruaj marrëveshjen kemi qen en Shkudre se bashku me delegacionin dhe e kemi nënshkruar marrevshejn tani kërkohet qe formalisht te miratohet këtu ne Kuvend ka gatishmëri dhe entuziazëm ne te dyja palët dhe këtë është nejtë gjë e mirë që ka ndodhur , ne së shpejti do ta nënshkruajmë marrëveshjen e bashkëpunimit edhe me Sarandën dhe do të vendosim simbolikat me te gjitha komunat qe kemi kësht bashkëpunimi andaj edhe një herë ju falënderoj te gjithëve për përkrahjen unanime për këto tema .

znj. Mimoza Shala : Unë pajtohem me atë që u tha nga kryesuesja dhe kërkoj që jo vetëm raportet ne fundit por të kemi një plan të punës nga të gjitha drejtoritë që kanë fushat e tyre në këtë marrëveshje në mënyrë që në fund vit ta kemi raportin se sa është realizuar planifikimi e jo të kemi një bashkëpunim vetëm në letër .

Kryesuesja: E qes në votim miratimi i normës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023, Kush është: **Për, Kundër, Abstenim.**

Nga Anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro**, pas votimit të bërë u miratua Ky :

V E N D I M

1. Miratohet Marrëveshja për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Bashkisë së Shkodrës, Republika e Shqipërisë .
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është marrëveshja e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Bashkisë së Shkodrës Republika e Shqipërisë, e nënshkruar nga Kryetari i Komunës së Gjakovës dhe Kryetari i Bashkisë së Shkodrës .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

3. Pika e tretë e rendit të ditës .: Propozim Vendimi për Ndryshimin e vendimit 01.nr.011-49415 i datës 25.11.2016

Kryesuesja : Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Propozim Vendimin për Ndryshimin e pikës 1 të vendimit 01.nr.011-49415 i datës 25.11.2016, prezent e kemi Kryetarin e Komunës të cilin e ftoj që ta merr fjalën .

Kryetari: Kjo pikë ndërlidhet me pikën pasuese dhe ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale ku në vitin 2016 është miratuar vendimin në kuvendin e Komunës që këto objekte të destinohen për banim Socialë ndaj kërkojmë që të ndryshohet vetëm kjo pikë për këtë objekt ndërsa pjesa tjetër e

vendimit mbetet në fuqi, dhe do të vazhdojmë me buxhetim për ndërtimin e banesave për banim Social, andaj ju kërkoj që ta mbështetni këtë vendim që vetëm ky objektet të hekët nga vendimi i kërkuar .

z. Ali Tafarshiku: Banoret e komunës së Gjakovës kanë vështirësi të shumta për sigurimin e strehimit , dhe në vitin 2016 e kemi votuar këtë pronë të destinuar për banim Social dhe janë edhe tri objekte tjera dhe nëse kjo parcelë nuk është e përshtatshme për banim social edhe këto objektet jera janë në të njëtin vend atëherë as ato nuk qenkan të përshtatshme , andaj mendoj se është e pa drejtë që një parcel të shkëputet nga ai vendim, Nuk mundemi me i ik përgjegjësisë sepse në ato banesa duhet ti bëhet zgjidhje sepse aty ka banor që e shfrytëzojnë pronën komunale pa u trajtuar përmes ligjit për banim social dhe ky venit është marrë pikërisht për këtë arsye. Tani po e logojmë këtë ndërtesë por çka po bëhet tri njësit tjera banesore që 5 vite jeni në qeverisje dhe ende nuk keni bërë asgjë dhe këto ndërtesa nuk janë përfshirë këto tri ndërtesa për banim social , andaj nëse është çështja për banim social duhet të ju epet mundësia për trajtimin sipas ligjit për sitjen e banesave në pronë si të komunës.

Kryetari: Ne kemi bërë thirrje dhe po vazhdon procesi për shitjen e banesave me të drejtë shfrytëzimi dhe nuk e dimë kur do të përfundoj procesi sepse shumë lëndë do të përfundojnë në gjykatë , qëllimi i komunës është që objektet tjera tanë pronësi të komunës të vazhdojnë procedurat sipas ligjit . Problemi të këto tri banesa është se njëra nga to në vitin 1999 ka qenë sikur kjo që është tani vetëm e ndërtuar e pa rregulluar për banim , dhe banorët kanë investua dhe i kanë bërë të banueshme andaj këto janë raste pak më të ndjeshme, dhe për këtë objekt ju e dini në çfarë gjendje është i pa banueshme . Unë kërkoj që ta votoni sepse e hap rrugën që të bëjmë diçka të mirë për këtë objekt që tai japim një zgjidhje .

z. Ledian Rexha : Në fushat keni premtuar se do të investoni për banim social , pse nuk po investoni në këtë objekt dhe me ju bërë zgjidhje disa familjeve që kanë nevojë për banim social

Kryetari: Jemi duke e ndërtuar objektin e banimit Social dhe ju thash se ne të gjithë botën objektet e banimit social janë në vende të caktuara e jo në rrugët kryesore ku ka biznes sepse ato vende duhet të shfrytëzohen për interes të komunës, ne jemi duke punuar dhe investuar për banim Social .

znj. Mimoza Shala : Nga ato që u thanë nga Kryetari aty në atë lagje nuk po bajka me jetu familjet me Social , ne të gjithë këtu e dimë se sa familje kanë nevojë për banim Social dhe nëse një herë u destinua për banim Social dhe që është marrë vendim për të tillë , tani e shihni të gjitha se sa ka me ërfitu Komuna nga ky objekt që po tentohet me i dhënë dikujt një biznesmen . Ne kemi nevojë për me i strehuar familjet që kanë nevojë për banim Social.

Kryetari: Vendimi është i juaji por unë kërkoj që të votohet , unë po ju them se tani nuk kemi rrugë tjera për këtë temë dhe nuk ka pengesa ligjore për me i ndjek këto procedura . Për banimet Sociale Objekti për banim Social është duke u ndërtuar rreth dy objektet tjera por edhe një herë po ju them se po insistoj me pas maksimizim të të hyrave të komunës dhe me menaxhimin e pronës me na sjell të hyra do të kemi më shumë investime andaj ky është edhe qëllimi i imi , pra edhe një herë kërkoj që ta votoni .

z. Agon Dobruna: Prej tri objekteve mendoj që të merret një iniciativë të investojmë dhe të vendosim familjet që janë me raste sociale andaj propozoj që të përfundojmë këtë objekt dhe ta shfrytëzojmë për banim Social sepse është një vend i përshtatshëm për këtë çështje .

Kryesuesja: E qes në Votim miratimin e Vendimi për Ndryshimin e vendimit 01.nr.011-49415 i datës 25.11.2016, sipas propozim vendimit dhe dokumenteve të Prezantuar për shqyrtim. **Kush Është Për , Kundër, Abstenim, Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit u votua kështu : 23 pro, 10 kundër dhe 0 abstenim : Pas votimit të bërë u miratua Ky :**

V E N D I M

1. Ndryshohet pika 1 e vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr.011-49415 i datës 25.11.2016 , për shfrytëzimin e banesave kolektive në pronësi komunale për Banim Social.
2. Nga pika e 1 e vendimit 01 nr.011-49415 i datës 25.11.2016 për shfrytëzimin e banesave Kolektive për Banim Social , largohet ndërtesa në parcelën 4501-38-80-0 e destinuar për banim Social .
3. Pjesa tjetër e vendimit 01 nr.011-49415 i datës 25.11.2016 për shfrytëzimin e banesave Kolektive për Banim Social mbetet në fuqi, dhe e pa ndryshuar .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

4.Pika e katërt e rendit të ditës: Propozim - Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale me numër të njësive kadastrale 4501-38 dhe 4501-38-30-0 Z.K- Gjakovë.

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Propozim - Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale me numër të njësive kadastrale 4501-38 dhe 4501-38-30-0 Z.K- Gjakovë, dokumentacionet ju kemi dërguar me kohë andaj e ftojme Kryetarin e Komunës që ta merr fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës

Kryetari: Në Bazë të ligjit në fuqi Kryetari i Komunës lejohet me negociua me dhen pronën në shfrytëzim dhe kjo është rasti i dytë , dhe qëllimi i komunës është maksimizimi i të hyrave të komunës, ne kemi negociuar për një kohë dhe e kemi krye këtë fazë tani . Në bazë të planit rregullues dhe DUMM ky objekt është i paraparë në planifikimin urban dhe ky objekt ka të bëjë me turizmin do të jen apartamente banimi afatshkurta pra me element të pastër turistik dhe do të mbetet përherë në pronësi të komunës , në këtë objekt do të ketë restorant dhe shërbime tjera hoteliere . Qiraja është e paraparë 1000 euro në vit duket e vogël mirëpo Komuna e Gjakovës i shpenzon diku 40,000€ ne vit për akomodime kur vinë delegacione zyrtare ne i sigurojmë akomodimin dhe ushqimet për dreka zyrtare këtu i kemi zbritje, dhe investimi është 1.3 milion pra , Operatori e merr në shfrytëzim objektin e investon pronësia mbetet e komunës dhe është i obliguar me i punësua 32 persona është i obliguar me i dhënë shërbime komunës me 30%zbritje çfarëdo shërbime që kërkojnë komuna dhe është i obliguar me e leshu sallën e takimeve kur di duhet komunës sa herë që kërkohet edhe i paguan për këtë pjesë edhe qiranë prej 1000€ në vit, nëse i llogarisim të gjitha me investime dhe pagesat që do të bëhen diku 1800€ në muaj .

znj. Mimoza Shala : Ne cilido biznes me i kërkua për mysafir të komunës do të jenë të lumtur me bë zbritje dhe kjo zbritje prej 300% po i bije se po ta japim në shfrytëzim por po ju sigurojmë edhe punën , ndërsa për zbritjen po flasim për 9 kate objekt dhe dy katet e para i ka biznes dhe kreit çka na ofron është një sall që duhet me kërkua një javë me herët , nuk po kuptoj se si po ja rrit vlerën pronës komunal , investimi është për përfitime të tij por komuna nuk përfiton asgjë nga kjo qira 1000 euro në vit e që në muaj i bije 83 euro, kati i parë ka me qenë kafeteri gjakova nuk ka pas nevojë për kafeteri, 31 të punësuar nuk ka të bëjë me ndonjë shpresë për të pa punët sepse bëhet fjalë për kamarja , roje , opastruese dhe dy menagjera që mesiguri janë anëtar të familjes kështu që këtu shihet se komuna nuk përfiton asgjë. Numrat i keni kur ti bëjnë propozimet kryetari ju jeni makineri votimi dhe po ju them prap , unë mendoj se nuk duhet me e kalu këtë vendim për me e dhënë pronën në këtë formë .

Kryetari: Mos harroni se deri në vitit 2018 ka pas dyqane në qendër të qyteti për të cilat është paguar qira 85 € dhe tani paguhet 1000€ pra e kemi të qartë se si maksimizohet prona , por ato ka në qenë objekte të

përfunduar , dhe është diçka tjetër me i kërkuar dikujt diçka tjetër kur kame investuar mbi 1.3 milion euro investim sepse objekti është i ndërtuar dhe në bazë të investimeve që janë bërë është investuar diku 20% , pra kur të llogariten humbjet dhe fitimi ti llogarisim të gjitha , ajo nuk shndërrohet në porën familjare por mbetet në prn të komunës dhe nëse nuk i përmbahet kontratës komuan e ja shkëput kontratën . Nisja e kësaj punë sështë që të përfundohet kjo pjes dhe të përfitoj komuna një kopani është ofruar dh eju kemi shpëdard dokumente dhe kërkoj që ta mbështesni këtë propozim .

z. Ali Tafarshiku; Me ofertuesin jemi takuar me kërkesën e ti dhe e kamë dëgjuar prezantimin e ofertës dhe ka tingllu si efikasitet i përgjithshëm , por tani kur po i shoh dokumentacionin dhe kriteret po zhgënjena edhe për kohën që a kamë kushtuar me e dëgjua , sepse destinimi i objektit nuk është hotelier , por k atë bëj me mërgatën tonë që mos të kenë problemin për me e gjet një banës me i qira, pastaj do të ja mendojmë komunës së Gjakovës që ta kem një zyre konstante aty e deri të një punësuar që mundet me ofroj shërbime për bashkatdhetarët e që nuk kanë nevojë me prit në radhë gjatë muajve të verës . këto janë disa nga pikat që i kemi diskutua me fortuesin .

Nuk është e sigjerta as profitabile vlera prej 1000 euro në vit , tek akomodimet e personave që e vizitojnë komunën e Gjakovës e që ka të bëjë edhe me promovimin e traditës e të tjera në Qytetin e Gjakovës. Ne i kemi muzetë në Gjakovë dhe me mungesë të ciceronit , dhe tani vizitorët paskan me shkua ne transit e me u informua për çarshinë e vjetër e kjo është absurde . Ka qenë shumë më normale që aty me qen një zyre për diasporën . Ne mundemi me than interesi i komunës por këtu nuk po shihet që komuna ka përfitim , u anulua vendimi paraprak që ja siguron strehimin disa familjeve dhe tani po dojmë me ja dhënë një biznesi për interes të tijë, për dyqanet e komunës që u përendën janë paguar me nga 6000 euro por nuk i ka marr komuna ju e dini mirë këtë sepse ne gjakove jetojmë .

Kryetari: Po filloj nga kjo e fundit me e dit se dikush i ka pagua 600euro për pronat e komunës por ju ne komuna e mos me e ngrit këtë çështje është fshehje e krimit, ju kisha lut me shkua në prokurori me dhe tregu e jo këtu , në pronat që është pagua 70 euro sot paguhen deri në 1000 euro dhe kurrë nuk ka funksionu me mirë , këtë e mora si dallim në mes pronës së pa përfunduar dhe atyre qe kanë qenë të gatshëm , unë nuk e bi një vendim për të cilin kamë me u turpnu në qytetin tim kurrë nuk e bëjë një që të tillë që e dëmton Komunën time , por ju lutem merreni totalin e investimit , qiranë, të punësuarit, zbritet që i bëhet komune , shfrytëzimin e hapësirave sallës, dhe pronësoja prapë i metët Komunës së Gjakovës .

Qe 30 vite ky objekt është si gërmadhë dhe nëse ne nuk angazhohemi mbetet edhe 30 vite tjera andaj për këtë po propozoj që ti bëjmë zgjidhej sepse edhe punësimi është zgjidhe sepse zgjedh problemi social i 31 familjeve .

znj.Mimoza Shala: U fol për ideologji dhe të qenurit socialdemokrat është shumë e emirë sepse nuk mundemi me i fuqizua bizneset dhe mos me ju ndihmua të varfërve, kur e dim se në Gjakovë ka kategori të ndryshme të rasteve sociale dhe duhet të ju ndihmohet. Çuditërisht ai ofertuesi pse ka kërkuar me u taku dhe unë sot po ju tregoj se kundër këtij vendimi është vetëm Grupi i Lëvizjes vetëvendosje dhe i ftoj grupin e Lëvizjes Vetëvendosje që ta lëshojmë Sallën .

Grupi i Lëvizjes Vetëvendosje e ka lëshuar Sallën .

z. Teki Shala : Ne Lidhja Demokratike e Kosovës nuk jemi vegël e Vetëvendosjes dhe jemi djathtistë kështu që i kemi pikëpamjet dhe Qëndrimet tan, dhe sipas vlerësimeve tona edhe veprojmë kështu që Vetëvendosje e ka drejtimin e vet dhe ne nuk jemi në koalicion dhe as nuk kemi ide të përbashkëta me Vetëvendosjen .

Kryetari; Me vjen Keq që grupi i Vetëvendosjes e lëshoj sallën nuk kanë nevojë dhe sa për ideologjitë unë jomë i përgatitur , dhe i djathtë do të thotë me e rrit masën monetare të shtetit dhe përmes kësaj rritje me u zhvillu , 3 objekte të banimit Social janë ndërruar që kur ekziston Komuna dy kur unë kamë qenë Ministër dhe një tani kur jam Kryetar i Komunës pra askush më shumë se unë nuk ka kontribut për këtë temë .

Kryesuesja: E qes në Votim miratimin e Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale me numër të njërive kadastrale 4501-38 dhe 4501-38-30-0 Z.K- Gjakovë, sipas propozim vendimit dhe dokumenteve të Prezantuar për shqyrtim. **Kush Është Për , Kundër, Abstenim, Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit u votua kështu : 24 pro, 1 kundër dhe 0 abstenim : Pas votimit të bërë u miratua Ky :**

V E N D I M

1. Miratohet Propozim Vendimi i Kryetarit të Komunës për dhënia në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale me numër të njërive kadastrale 4501-38 dhe 4501-38-30-0 Z.K Gjakovë, e evidentuar në Pronësi të Komunës së Gjakovës, sipas marrëveshjes së negocimit të ofertës mes të Komunës së Gjakovës dhe “Letaj Home” Sh.P.K, me numër 01-413/01-23301, të datës 17.10.2022.
2. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale sipas pikës 1 të këtij vendimi është afatgjatë, përkatësisht 99 vite.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është interesi publik, përfitimi ekonomik i Komunës nga prona komunale, si dhe funksionalizimi i pronës komunale.
4. Mënyra, kushtet dhe kompensimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës, do të përcaktohen në kontratë sipas marrëveshjes së negocimit të ofertës në mes të Komunës së Gjakovës dhe “Letaj Home” Sh.P.K me numër 01-413/01-23301, të datës 17.10.2022.
5. Pjesë përbërëse e vendimit janë: Kërkesat e palës, Marrëveshja e negocimit të ofertës mes Komunës së Gjakovës dhe “Letaj Home” Sh.P.K, Projekti i paraqitur nga investitori dhe plani dinamik i realizimit të investimit, paramasa dhe parallogaria, Certifikata e pronësisë dhe kopja e planit, Certifikata e regjistrimit të biznesit, Vërtetimi që nuk ka obligime tatimore, si dhe qarkullimi bankar për vitin paraprak i biznesit “Letaj Home” Sh.P.K.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

5. Pika e pestë e rendit të ditës: Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit nr. 01-011-78400 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale “ Tregu në Orize”.

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit nr. 01-011-78400 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale “ Tregu në Orize, andaj ftoj Kryetarin Komunës së Gjakovës që ta merr fjalën lidhur me këtë pikë .të rendit të ditës.

Kryetari: Këtu kemi të bëjmë me shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim të tregut në Orizi Komuna ka marrë vendim që pasi që ka dështuar disa herë procedura për dhënien në shfrytëzim të tregut në Orizi ta ja japim në shfrytëzim Ndërmarrjes Komunale KRM Çabrati që ta menaxhoj këtë treg . për këtë arsye duhet me u shfuqizua vendim .

Kryesuesja : E Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës .

znj. Shqipe Fejza: Ne si komision për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone nuk jemi njoftuar fare për këtë çështje andaj mendoj se janë tejkaluar kompetencat dhe unë kamë kërkuar që ti kemi Vendimin dhe Kontratën që kanë parregullsi sepse në Kontratë shet shënuar se epet për dy vite ndërsa në venim është shënuar për një vit .

Kryetari: Mundet me pas ndonjë parregullsi por është kërkuar vlerësimi i ligjshmërisë dhe e kemi marrë vlerësimin se është në rregull . Deri te këto veprime kemi aradhe ngase ka disa herë që dështon procedura për me e dhen në shfrytëzim këtë tregu dhe ne nuk mundemi në pa kufij me e mbajt atë gjendje , ne nuk kemi negociua për këtë kontratë por kemi vepruar në bazë të ligjit që na lejon që ndërmarrjeve publike me ja delegua disa punë që mundet me i krye dhe kemi vepruar në këtë mënyrë .

Kryesuesja: E qes në Votim shfuqizimin e vendimit nr. 01-011-78400 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale “Tregu në Orize”. **Kush Është Për , Kundër, Abstenim**
Nga Anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro kësaj pike** , pas votimit të bërë u miratua Ky :

V E N D I M

Për

Shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01nr -011/01-13700 të datës 26.05.2022

1. Shfuqizohet Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale “Tregu në Orize” i Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01nr 011/01-13700 i datës 26.05.2022 .
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

6.Pika e gjashtë e rendit të ditës: Miratimi i Buxhetit Suplementar për vitin aktual 2022 .

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Miratimi i Buxhetit Suplementar për vitin aktual 2022, pra edhe në këtë vit Komuna e Gjakovës ka arritur që të ketë Buxhet Suplementar andaj fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z. Durim Halilaj .

z. Durim Halilaj: Komuna e Gjakovës ka pasur në planifikim që të grumbulloj të hyra af4 milion euro në raportin e tret financiar komuna e Gjakovës ka arritur te tejkaloj planifikimin dhe në periudhën e parë të muajit Tetor po ashtu ka vazhduar inkasomi me trend të rritjes dhe ne si drejtori për shkak të rritjes së çmimeve kemi propozua që në kategorinë mallra dhe shërbime ti shpërndajmë këto mjete sipas dokumenteve që ju kemi shpërndarë në vlerë prej 230.000 euro . Deri më datën 18 .10 Komuna e Gjakovës a inkasuar mjete në vlerë 230,000 ndërsa ame raportin që e kemi mrë sot Komuna e Gjakovës i ka inkasuar mjetet në vlerë prej 4,7000,000 euro , pavarësisht rritjes së buxhetit Suplementar buxhetin e kemi më të madh dhe do të kalojnë në me bartjen e mjeteve . Këto mjete janë shpërndarë sipas dokumenteve që ju kemi shpërndarë .

Kryesuesja: E Hapi diskutimin për këtë pikë .

znj. Mimoza Shala: Të hyra vetanake ka edhe drejtorja e Arsimit dhe e Shëndetësisë dhe shpërndarja që është bërë ka destinacion se ku duhet të shkojnë këto mjete dhe në të njëjtin kohë po thua se duhet e i kryer obligimet kontraktuale që i ka komuna për cilat obligime po folni, sepse në të gjitha ndërmarrjet publike komuna ka borxh .

z. Durim Halilaj: Drejtorja e Arsimit dhe e shëndetësisë i kanë grandet Specifike buxheti i komunës së Gjakovës për vitin 2022 është miratuar ne shtator te vitit te kaluar , dhe pastaj ka ndodhur inflacioni dhe kontratat nuk kane mundur te jen ato me vlerën fillestare dhe tani kjo është efekti i inflacionit dhe ato obligime që do të bartën ë vitin 2023 ne do të rrisim këtë pjesë në kategorinë e mallrave dhe shërbime .

Kryesuesja: E qes në Votim miratimin e Buxhetit Suplementar për vitin aktual 2022, sipas dokumenteve të prezantuara nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, **Kush është: Për, Kundër, Abstenim.**
Nga Anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës **unanimisht u votua pro kësaj pike**, pas votimit të bërë u miratua Ky :

VENDIM

Për Rritjen e të Hyrave Vetanke me Buxhet Suplementar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për rritjen e planit të të Hyrave Vetanke me Buxhet Suplementar me vlerë prej 230,000.00 €.
2. Shuma e prej 230,000.00€ si rritje e planit të të hyrave vetanke si Buxhet Suplementar shpërndahet në kategoritë Buxhetore si vijon :

Mallra dhe Shërbime 230,000,00 €

Shpërndarja bëhet në Programet:

Administratë të Përgjithshme (16316).....	30,000.00€
Shërbime Publike (18016)	150,000,00€
Shëndetësi (73950)	20,000,00€
Arsim parashkollor (92510).....	30,000,00€

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë dokumentet e prezantuara nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa për rritjen e planit të të Hyrave Vetanke me Buxhet Suplementar me vlerë prej 230,000.00 €.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Kryesuesja: Tani do te kemi një pauzë prej një orësh dhe ju ftoj që mos të vonoheni .

7. Pika e shtatë e rendit të ditës: Shqyrtimi i informatës së tretë periodike financiare Janar – Shator 2022.

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i informatës së tretë periodike financiare Janar – Shator 2022, andaj e ftoj drejtorin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z. Durim Halilaj që ta merr fjalën .

z. Durim Halilaj: Informata Financiare Komunal për periudhën Janar – Shtator 2022, bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e neneve 46.1 dhe 46.2 të Ligjit Nr. 03/L-048. Informata Financiare Komunal Periodike ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë. Buxheti Komunal i aprovuar në vlerë 27,816,931.00€, për këtë periudhë ka rritje buxhetore për 2,401,635.28€ Buxheti pas rritjeve për këtë periudhë ka arrit në 30,218,566.28, këto ndryshime kanë ndodhur nga Grandi qeveritar. Paga dhe mëditje mjete të shpenzuar 10,059,422.52€ , mallra dhe shërbime 2,196,598.33€, shpenzime komunale 330,528.83€, subvencionet 309,166.22€, shpenzimet kapitale 3,193,376.07€. Në total shpenzimet krahasuar me alokimet kemi për këtë periudhë 62.17% realizim ndërsa krahasuar me periudhën e vitit paraprak kemi shpenzim për 11.75% me të ultë.

Kryesuesja: E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës

z. Ali Tafarshiku Tek krahasimi i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike e kemi potencuar se si është e mundshme që përfituesit e subvencioneve si kategoritë me e ndjeshme të kemi më pak se gjysmën e shpenzuara prej mjeteve të alokuara kur e dimë se janë edhe 3 muaj deri në përfundim të këtij vitit, shpenzim të ulët kemi edhe mallra dhe shërbime edhe tek komunalit, kemi ngritje tek udhëtimet zyrtare jashtë vendit krahasuar me vitin e kaluar janë shpenzuar dyfish më shumë, si dhe tek mobilet më pak se 1000€ çfarë mobileje janë blerë me këto shpenzime që krahasuar me vitin e kaluar janë shumëfish më shumë, për karburantet për vetura krahasuar me vitin e kaluar është shpenzimi më i madh, tek shpenzimi për mirëmbajtjen e auto rrugëve lokale si dhe disa nga kategoritë tjera. tek shpenzimet periodike kemi përqindje të ultë të shpenzimit, si tek DKRS, DZHE, tek shërbimet Publike pse kjo përqindje e ultë e shpenzimeve në raport me mjetet e alokuara. Tek rregullimi i shtratit të lumit krena janë shpenzuar 24% pse ka ndodh kjo, për shpenzimet e shkalleve në çabrat ku janë shpenzuar këto mjete, tek rregullimi i hyrave të banesave kolektive pse nuk janë shpenzuar mjetet e alokuara, andaj kërkojmë që të na sqarohen këto mungesa tek mjetet e alokuara.

z. Durim Halilaj: Buxheti i Komunës Gjakovës është operacionalizuar në muajin Prill, sa i përket subvencioneve Drejtoritë janë në procedurë të shpërndarjes siç është Drejtoria e Bujqësisë që është në procedurë, ajo e zhvillimit Ekonomik është në fazën e shpërndarjes së Grandeve, Drejtoria e Kulturës rini dhe Sport ki ka shpërndarë, DKA-ja i ka shpërndarë dhe kjo është situata me subvencione që mendoj se janë në rregull dhe do të arrihet realizimi i shpërndarjes

Për mallra dhe shpenzime duhet të kuptojmë se shkollat kanë qenë në Grevë dhe shpenzimet nuk janë bërë por konsideroj se do të arrihet shpenzueshmëria e këtyre mjeteve, për Udhëtimet jashtë vendit Komuna e Gjakovës ka pasur vizita zyrtare dhe është vepruar sipas legjislacionit në fuqi vitin e kaluar nuk ka pas vizita. Tek projektet kapitale trendi i shpenzueshmëris nuk ka shkua sikur vitin e kaluar por tani jem në procedurë dhe shpresojmë se do të arrihet vlera prej 80% e shpenzueshmëris, për lumin krena është kryer pagesa e për loton e tetë, Shkallët në Çabrat janë duke u punuar dhe ju ka bërë një pagesë, edhe hyrjet e banesave janë duke u punuar dhe është duke u realizuar kontrata.

Kryetari: Ajo që duhet me iu cekë është se për të 5 vit me radhë Komuna e Gjakovës i ka tejkaluar të hyrat e veta, dhe gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur fare rritje të taksave apo tarifave por kjo ka ndodhur falë punës së mirë që është bërë në komunës dhe falë respektimit të rregullave nga Qytetarët e Komunës së Gjakovës, Për herë të parë në Histori Komuna e Gjakovës e tejkalon vlerën prej 5 milion me të hyrat e veta, për udhëtimet zyrtare në vitin 2022 nuk kemi pasur fare, në vitin 2021 kemi pasur shumë pak për shkak të pandemisë, ndërsa në këtë vit ka pasur nxënës dhe zyrtar të tjerë që kanë udhëtuar dhe janë të gjitha transparente, shpenzim në nivel të kosës është 21 % Ndërsa në nivel të qeveris janë në 12 % ndërsa komuna e Gjakovës sot është në #5% që shpresoj se do të arrihet shpenzueshmëria dhe do të kualifikohemi për grand të përformancës. Ka punë të kryera por ende nuk kanë ardhur faturat dhe detyrimisht për fund po ju them se tek mallrat dhe shpenzimet rrihen por mos harroni se 4 muaj i kemi pasur në Bllokada për shkak të Buxhetit.

Kryesuesja: Meqenëse se nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

8. Pika e tetë e rendit të ditës: Shqyrtimi i informatës mbi implementimin e Planit për Investime Publike Janar – Shtator 2022

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i informatës mbi implementimin e Planit për Investime Publike Janar – Shtator 2022, andaj për sqarime më të hollësishme e ftoj drejtorin e Drejtorisë për Shërbime Publike z. Shkumbim Kastrati që ta merr fjalën.

z. Shkumbim Kastrati: Pas përfundimit të mbledhjes së KPF-së i kemi realizuar disa projekte si në Fshatin Cermjan, në Fshatin Ujz, Kanali në Rogovë që shpresojmë se për një javë do të realizohet, është përmbyll projekti i kanalizimit të Pika e zezë, në këtë javë do të bëhet asfaltimi i rrugës për Prizren, po ashtu edhe

rruga Skënderbeu do të përmbyllet për 10 ditë, sot kanë filluar punimet për zgjerimin e rrugës për Pejë , projekt me vlerë prej 1 milion euro , tek ndriçimi publik janë duke punuar 2 ekipe në Rugovë , në Pnish, në Damjan në lagjen Shehu, në Muhadër dhe do të kryejmë në lagje në Rogovë me komunitetin pakicë dhe besoj se për 3 ose 4 dit do të përmbyllet hasi dhe të fillojmë me regjionet tjera .

Në këtë raport i keni të detajuara të gjitha projektet e realizuara gjatë kësaj periudhe janë edhe punimet të cilat janë ndërpre dhe jonë shkëput kontratat të paraqitura në këtë raport janë edhe projektet të cilat janë në tenderim në procedura të prokurimit dhe projektet të cilat janë përfundua. Investimet nuk janë të kënaqshme jo vetëm në nivel të komunës por edhe në nivel qendror jemi duke u mundura të i shtyjmë projektet përpara, projektet të cilat kanë ngeçë janë kryesisht projekte të financuara nga bashkimi evropian dhe donator të jashtëm, ndërsa për projektet infrastrukturore ne komunën po ju njoftoj që Cermjani është duke asfaltuar ,presim te ja nisim zgjerimit te rrugës për Prizren ndërsa për zgjerimin e rrugës për Pejë është zgjedhur operatori ekonomik si dhe do te sanojmë edhe pjesën e mbetur prej gjykatës deri te zjarrfikëset, do te vendoset ndriçimi dhe instalimet nëntokësorë. Ndërsa vitin tjetër do te vazhdojmë prej gjykatës sepse aty ka edhe shpronësime, jemi duke u munduar qe ta arrijmë shpenzushmërin për të qen të kualifikuar dhe për të arritur fonde .

Kryesuesja: E Hapi Diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës .

z. Agustin Shala : Unë mora shkas nga fjala e drejtorit që u tha se Rajoni i Hasit është i kryer unë po ju them se një përqindje e madhe nuk është e përfunduar me ndriçim publik , dhe kërkoj që të ndriçohen fshatrat që i përmend sepse është shumë e nevojshme ndriçim në këto fshatra .

Kryetari: Planifikimi i komunës është që të kemi ndriçimin Publik ë ët gjitha fshatrat dhe lagjet në komunën e Gjakovës mirëpo nuk bëhen të gjitha menjëherë , problemi ka qenë edhe kur janë ndërru shtyllat e Energjisë elektrike është dëmtuar rrejt i ndriçimit publik dh etani jemi duke punuar që të gjitha rrugët të kenë ndriçim publik .

Kryesuesja : Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur diskutimin për këtë pikë të rendi të ditës .

9. Pika e nëntë e rendit të ditës: Shqyrtimi i informatës mbi implementimin e Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave 2021-2025

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i informatës mbi implementimin e Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave 2021-2025 andaj për sqarime më të hollësishme e ftoj drejtorin e Drejtorisë për Shërbime Publike z. Shkumbim Kastrati që ta merr fjalën .

z. Shkumbim Kastrati : Edhe për këtë pikë po tentojmë të jemi i shkurtër në fjalim, lajm i mirë është se tani është nënshkruar kontratën për Qendrën Transfer dhe besojmë se shumë shpejt do të fillojnë punimet , dhe besojmë se të hënën do të fillojmë me pastrimin e Qendrës Transfer. Për deponin e mbetjeve inerte në KPF ju kemi thënë se e kemi identifikua një parcela tek Deva, por sipas informacioneve që kemi marrë edhe ai lokacion nuk i plotëson kriteret sepse ka uji në afërsi dhe tani jemi duke punuar që të gjejmë një lokacion tjetër .

Kryesuesja: E Hapi Diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës .

z. Teki Shala: Ne kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së dhe shpresoj që Qendra transfer të rregullohet sa më parë , por tek mbeturinat inerte nuk po shoh seriozitet në këtë drejtim sepse jemi dëshmitar që të gjithë shtretërit e lumenjve janë shkatërruar nga Mbeturinat inerte dhe kërkoj që të caktohen më shumë deponi për inerte sepse vetëm një është pak , dhe kërkoj që për këtë temë komuna urgjentisht të bëjë zgjidhje .

Kryetari: Gjetja e një lokacioni për mbeturinat inerte është një punë e vështirë por në vazhdimësi jemi interesuar dhe do të bëjmë një zgjidhje sa më parë që të jetë e mundur , lumenjtë janë duke u dëmtuar edhe nga mbeturinat tjerra , u përmenden me të drejtë edhe mbetjet shtazore edhe për të gjitha këto duhet të kemi bashkëpunim me qytetarët në mënyrë që ne të veprojmë sipas rregullave të përcaktuara për stacionin transfer janë kryer procedurat aty do të punojmë në vazhdimësi sipas planifikimit ku pas pastrimit do të vazhdojmë me mbjellje dhe në pjesën tjetër do të vendoset operativa e Çabratit sepse ashtu jemi dakorduar që të hoqën makineritë nga aty ku janë sot sepse po shkaktojnë probleme për qytetarët .

Kryesuesja : Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës .

10.Pika e dhjetë e rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit vjetor Financiar i Ndërmarrjes K.R.M “ Çabrat” për vitin fiskal 2021.

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i raportit vjetor Financiar i Ndërmarrjes K.R.M “ Çabrat” për vitin fiskal 2021, Prezent e kemi kryesuesin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për këtë ndërmarrje z. Durim Halilaj andaj e ftoj që ta merr fjalën dhe të prezantoj këtë raport .

z. Durim Halilaj : Fillimisht i falënderoj anëtarët e Komisionit Komunal të aksionarëve ne kemi punuar ngushta me Krye shefi e ekzekutiv dhe me Bordin e Ndërmarrjes KRM Çabrat , ne i kemi dhënë rekomandimet tona për zgjerimin e kësaj ndërmarrje , materialët i keni marrë me kohë ndërmarrja operon me vlere prej 1.5 milion euro në vit ndërsa në materiale i keni të detajuara pasqyrat financiare dhe të gjitha detajet tjera në këtë materiale që është raport financiar për vitit 2021 , Komuna e Gjakovës kësaj ndërmarrje nuk do ti marr disidenten .

Kryesuesja: E hapi diskutimin për këtë pikë.

z. Agustin Shala : Në këtë material që unë e kam pranuar është një raport përmbledhës por raport financiar nuk ka .

Z. Durim Halilaj: Unë ju kamë përcjellë Raportin financiar dhe atë të auditorit dhe me dijeninë time dje gjatë ditës ju kanë përcjellë ato dy materiale . KRM Çabrat ka 3,5miljon euro pasuri .

z. Agon Dobruna: Unë dua që ti bëjë disa rekomandime për Ndërmarrjen KRM Çabrat që të hartohet një planë për menagjimin e tregjeve në Komunën e Gjakovës meqenëse se komuna është pronarë dhe mundemi me e mbështet me mekanizmat e saja që të zhvillohet kjo ndërmarrje, njëit kamë propozuar edhe për parkingjet për Stacionin e autobusëve . Kërkojmë që të sigurohet një parcelë për varrezat sepse është koha e fundit .

z. Ali Tafarshiku: Çka është ndërmarr nga Komisioni komunal i aksionarëve lidhur me rekomandimet e këtij raporti ku njëri nga rekomandimet është borxhi i akumuluar nga Komuna pse nuk është pagur , pse nuk trajtohet çështje për shlyerjen e borxheve të vjetra , trajtim i shfrytëzimit të palltos tek zyrën e administratës së ndërmarrjes .

znj. Diana Qarkagjia: Lidhur me mbeturinat n bllokun e ri ku në një aneks të rrethuar aty është kthyer në vend të VC publike dhe kjo është e dhimbshme sepse aty ka banor dhe fëmijë që jetojnë dhe qarkullojnë si dhe mbeturinat hedhen edhe nga banorët tjerë që nuk paguajnë dhe i hedhin mbeturinat aty kështu që duhet të gjendet një zgjidhje . Tek Oborri i shkollës Yll Morina te këndi është duke u punuar me zhavorr çka do të bëhet me atë pjesë .

Kryetari : Me marrjen e tregut në menaxhim nga Qabrat do të rregullohet edhe ai problemi që e ngritët këtu dhe kjo ka qenë arsyeja që ne kemi vepruar me këtë çështje , disa nga tregjet janë private dhe disa kanë

kontrata , për punimet që janë duke u zhvilluar tek shkolla Yll Morina që rregullohet aty do të jetë parking, aty ka filluar projekti për parking

z. Agustin Shala: Unë kamë një pyetje lidhur me investimet financiare afatshkurtër në velurën mbi 700,000€ në kategorinë pasurive afatshkurtra , çka është kjo pasuri .

z. Durim Halilaj: Në Janar të këtij vitit ne si komision i aksionarëve i kemi rekomanduar Boritit që të hyrat nga komuna dhe një pjesë të fitimit të shkoj në asete të reja , dhe mos të falë burgjet , për varrezat e qytetit ne jemi në dijeni dhe jemi duke punuar për ta siguruar parcelën , ndërsa sa i përket kërkesës për mirëmbajtjen e varrezave nëpër fshatra jemi duke punua për ti vërtetuar se ku ndodhen varrezat në pronësi të kuajt janë parcelat dhe pastaj mundemi me e nxjerre një përfundim . Për çështjen e asaj që u tha për pasurit afatshkurtra mendoj se munden me qen fjala për pajisje, dhe e kemi edhe raportin auditorit që thotë vlerësimin e aseteve KRM Çabratit obligohet që ta bëjë nisa afateve ligjore , kjo ndërmarrje është një ndër ndërmarrjet më të qëndrueshme .

znj. Mimos Shala: Ne jemi të kënaqur me punën e punëtorëve të Çabratit , ju bashkëngjitëm kërkesës së Kryetarit që të kemi bashkëpunim me qytetarët , Pse komuna ka borxh ndaj KRM çabratit

z. Durim Halilaj: Në të kaluarën e kanë pasur anëtarin në komision të aksionarëve dhe nuk ka qenë i ngritur ai rekondim që po kërkohet këtu , për pjesën e borgjeve drejtorit komunale duhet ti paguajnë obligimet ndaj çabrait , Komuna e Gjakovës i ka pasur obligim kësaj kompanie afër 100,000 euro dhe ato mjete janë paguar në Janar

z. Ali Tafarshiku: në e parashtrova Pyetjen se si ka mundësi që një raport i ndërmarrjes rekomandimet kryesore i ka ndaj jush , dhe këto probleme janë në vazhdimësi , Sektori i aneksimit përqindjen më të ulët janë tek institucionet dhe tek bizneset e mëdha .

z. Durim Halilaj: Institucione Publike nuk janë vetëm Komuna por ka edhe institucione të tjera që ndërmarrja ju kryen shërbime siç është spitali e të tjera , në informatën Financiare të komunës në muajin Mars ju kemi prezantuar të gjitha detajet edhe të borxhit ndaj kësaj kompanie

Kryetari: KRM Çabratit nuk e ke me komunën vetëm kontratën e grumbullimi të mbeturinave por e ka edhe kontratën e gjelbërimit që në të kaluarën nuk e ka pas dhe paguhet me pozicione, si dhe gjatë verës e kanë edhe ujitjen pra kanë disa kontrata të tjera dhe gjendja financiare e kanë më të mirë se asnjëherë më parë, qytetarët i shohin punëtorët e kësaj ndërmarrje.

Kryesuesja : Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

11. Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Ndërmarrjes Publike Lokale NP “ Ngrohtorja e Qytetit” për vitin fiskal 2021

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Ndërmarrjes Publike Lokale NP “ Ngrohtorja e Qytetit” për vitin fiskal 2021, prezent e kemi Kryesuesen e Komisionit Komunal të aksionareve znj. Adea Roka të cilën e ftoj që ta merr fjalën për këtë pikë .

znj. Adea Roka: Informatat janë plotësuar sipas kërkesës së juaj nga KPF-ja dhe ju kemi shpërndarë me kohë dhe krahasuar me vitin 2020 kemi pasur një gjendje më të mirë dhe qysh jeni në dijeni kemi qenë në rehabilitimin e rrjetit dhe me investime në asetet e kësaj ndërmarrje të gjitha detajet i keni në materialet e juaja nëse keni ndonjë paqartësi jemi këtu .

z. Agustin Shala: A ka përfundua ndërtimi i Ngrohtores së Qytetit a është funksionale Ngrohtorja e qytetit për momentin, cila janë këto poziciona të hyrat e shtyra afatgjata mbi 13 milion çka nënkupton , tek rrjedha e parasë paraqitet se kjo ndërmarrje operon me një afarizëm negativ pra është ka punon me humbje .

Kryetari: Informatat që epen sot janë që rrjedhin nga obligimet ligjore që kryesuesit e komisioneve të aksionarëve duhet të prezantojnë raport financiar në Kuvendin e komunës, te ngrohtorja kemi situatë specifike sepse asetet e ngrohtores janë mbi 20 milion € por shitja është me probleme sepse përcaktohet nga rregullatori jo komuna e çmimin e blerjes së lëndës djegëse e përcakton tregu , ngrohtorja e kalkulon se sa i kushton një kilovat or nxehje dhe me caktim vet por nuk ka mundësi me e caktu çmimin se e cakton ZRRE-ja kur kemi qenë në fazën e testimit çmimi i biomasës u sjell diku 60 deri 70€ e sot jemi duk e blere me 200€ dhe nuk ka gjasa me punua me profit sipas këtyre çmimeve, e në këto rrethana ne kemi kërkuar ndihmë prej qeverisë dhe dy ngrohtrët në Kosovë kurrë nuk kanë punuar me profit . Në këto kushte të tregut kur të fillojmë me shit energjinë që prodhohet në ngrohtore çmimi është 80€ e prej tjetër kund blihet edhe me 500€ pra kjo është situata . Në këto rrethana e kemi marrë mbështetjen e qeveris së Kosovës dhe i falënderoj që tani është vendosur .

z. Ledian Rexha: Në mbledhjen e kaluar Kryetari e ka quajtur ministrinë një far dembeli aty andaj po ju sqaroj se në vitin 2021 ministria ekonomisë i ka ndarë 300,000€ por ngrohtoren e Gjakovës duke e përpara se kjo shumë do të mbuloj edhe vitin 2022-2023 , në muajin mars ngrohtorja e Gjakovës ka kërkuar nga Ministria se na duhet prapë subvencione në vlerë prej 500.000€ , dhe me 24.06, e kemi pasur ministren e ekonomisë në gjakove dhe ju keni deklaruar në shtator se nga marsi nuk kemi pas asnjë komunikim me ministrin e ekonomisë , dhe pasi keni për kërkesë ministria e financave me 17 gusht e ke miratuar buxhetin prej 350,000€ për ngrohtoren e qytetit me synimin që 150,000€ ti ndaj edhe komuna dhe pasi që komuna nuk e ka bërë këtë qeveria është duke shikuar mundësit me i mbulua edhe këtë pjesë

Kryetari: Ligji për qeveri nuk ka ndërruar kurrë dhe deri në një shumë të madhe buxhetore ministri ka të drejtë me i ndryshua linjat dhe komunat këtë mundësi nuk e kanë . Gjakova i ka mare 400,000€ në vit ndërsa Prishtina i ka marrë edhe nga 3 milion € vit, andaj ne duhet të kërkojmë për Komunën e Gjakovës . Unë e falënderova në fillim të fjalisë qeverinë por po të na i kishte nda mjetet kur ka qenë koha që ne ju kemi kërkuar biomasën do ta kishim siguruar me 100 ose 110€ e tani e bleim 50% më shtrenjtë me 200€ për ton kjo është realiteti që do me thënë se blejmë biomasë ma pak dhe ngrohja përfundon ma herët kjo është arsyeja .

z. Ledian Rexha : Unë e shpjegova pse nuk janë ndarë mjetet në muajin Mars dhe po të mos kishit bërë ju opozitë këtu as unë nuk kisha dal këtu fare.

Kryetari: Të gjithë qytetarët me njohin dhe nuk lejoj me më bullizu askush në bot thuaje çka ki me thënë .

z. Ali Tafarshiku: Raporti për Ngrohtoren e Qytetit në KPF ka qenë një raport amator , Ngrohtorja e ka natyrën e punës që është e rëndësishme për Qytetarët . Për ngrohtoren e kemi një projekt që është donacion dhe është i pari në Ballkan me Biomasë dhe ne duhet ta ndijme si obligim .Më intereson për problematikat që janë përball ngrohtorja nga viti në vit por pas ndërtimit të objekti të ri kem mendu se menaxhimi ka me qen me efikas , në cilin muaj janë barazuar pagat me punëtorë sepse nga viti në vit ka pasur mungesë të pagesave pse ka vazhdua kjo çështje, prej kuit është sigurua biomasa në fazën testuese , kjo është me rëndësi m e dit sepse e në raport janë ngrit të hyrat nga inkasomi , njëri nga borgjilitë është DKA-ja dhe a e keni shqyrtuar mundësin që me përmbarues me i marr këto mjete , a ka iniciativë për me u taku me përfaqësuesit e pyjeve që biomasa të sigurohet përmes qendrave grumbulluese biomasa për këtë ngrohtore .

Kryetari: Biomasa në fazën testuese ka qen pjesë e mbuluar prej operatoreve që e kanë ndërtua ngrohtoren dhe pastaj është prokuruar biomasa dhe në këtë vit prap është prokuruar biomasa , ne mundemi me kalua ka kritikën për ngrohtoren por unë jam shumë i kënaqur me menaxhimin e këtij procesi të komplikuar me teknologji por është menaxhuar mirë dhe i falënderoj për këtë punë ët mirë. Për pjesën e subvencionimit

komuna nuk ka të drejtë, pjesa më e madhe e qytetarëve të komunës nuk ngrohen nga ngrohja, njësorët e vendosur nuk janë operacional edhe në këtë vit do të punohet me m2 andaj kërkoj që mos të abuzohet me ngrohjen në këtë vit sepse është mëkat , dhe nga viti i ardhshëm do të funksionalizohen njësorët dhe atëherë do ti ndalin vet e jo me i hap dritaret.

Kryesuesja : Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur diskutimin për këtë pikë të rendi të ditës .

12. Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i N.P.L “Stacioni i Autobusëve” SH.A për vitin fiskal 2021.

Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i N.P.L “Stacioni i Autobusëve” SH.A për vitin fiskal 2021., prezent e kemi Nënkryetari e Komunës z. Flamur Fetahaj që është Kryesues i Komisionit Komunal të aksionareve për këtë ndërmarrje, të cilin e ftoj që ta merr fjalën për këtë pikë .

z. Flamur Fetahaj: Fillimisht e falënderoj bashkëpunëtorët e mi anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve për punën e bërë , Ndërmarrja Publike Komunale Stacioni i Autobusëve në Gjakovë tani i ka zgjedhur organet e veta Bordin e Drejtorëve dhe Kreyshefin Ekzekutiv.

Kjo ndërmarrje ka pasur kujdes në shpenzime ku në vitin 2021 ka shpenzuar më pak se në vitin paraprak në vlerë prej 8300 euro , sa i përket të hyrave kjo ndërmarrje ka dy lloj të hyrave, nga Peronizimi dhe nga Qarat ku në të dyja këto ka ngritje ku në vitin 2020 ka pasur të hyra në vlerë prej 91. 977,00€ ndërsa në vitin 2021 ka pasur 30,000€ më shumë nga peronizimi , kurse nga qiratë ka pasur në 60,479,00€, ndërsa në vitin 2021 kemi 72,749,00€ pra i kemi mbi 12,000€ më shumë të inkasuar. Në total të hyra kanë qenë 203,073 ,00€ në vitin 2021 ndërsa në vitin 2020 i kemi pasur në total 1649,00€, kemi pasur edhe një ndihmë subvencion nga qeveria për vitit 2019 ndihmë për shkak të Pandemisë në vlerë 37,700€.

Stacionet e autobusëve licencohen njëherë në 5 vite dhe Stacioni i Gjakovës do të aplikoj në vitin e ardhshëm ka qenë një kriter bazë që të kenë minimumi 15 peronizime dhe në gjakove kanë qenë 12 dhe jemi detyruar që ta rrisim në 15 perone dhe e kemi përmbush këtë kriter .

Kryetari: Ju kërkoj falje se pas këtij fjalimi po më duhet me lëviz sepse është hera e tretë që e kam shtyre një angazhim sepse kam mendu se kryhet kjo mbledhje më herët. Në pasqyrat financiare kjo ndërmarrje del mirë për vitin 2021 , Ndërmarrjet duhet me krijua profit dhe me e përdor për me u zhvillu , ne jemi duke menduar që ta fillojmë me transportin Urban jemi duke punuar që të shndërrohet në një ndërmarrje profitabile , para se të lëvizi nga kjo mbledhje ju kërkoj që të keni në konsideratë të ju njoftoj për këtë pika që janë hy si pika shtesë në këto mbledhje që kanë të bëjnë me

Rishikimi i Vendimit 01 nr.011/01-21906 i datës 28.09.2022 për caktimin e Lokacionit për ndërtimin e Qendrës Ditore për Pensionistë në Komunën e Gjakovës, që është kthyer nga Ministria me arsyetimin se nuk çeshite e përpara në Dokumente e planifikimit hapësinor ,e jemi të detyruar ta shfuqizojmë , tjetër është Rishikimi i vendimit 01nr011/01-21911 i datës 30.09.2022 për mbështetje Financiare të Shoqatës Handikos, me arsyetimin se nuk kemi mjete sepse ka ndodh një gabim sepse mjetet kanë qenë të ndara dhe të zotuara, tjetër kemi Rishikimi i Rregullores 01 nr.110/04-21913 e datës 28.09.2022 për Taksa komunale edhe kjo është hera e tretë që po e kalojmë këtu në kuvend sepse nuk kemi rrugë tjetër edhe pse ka lëshime dhe vonesa nga ministritë mirëpo jemi të obliguar ti rishikojmë .

Kryesuesja: E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës ndërsa për ato që i sqaroj kryetari do të kalojmë në procedura për secilën nga to .

znj. Mimoza Shala: Nuk është në rregull me shkel rregulloren sepse ne jemi në pikë të rendit të ditës e kryetari me i raportua të gjitha pikat tjera dhe me shkua, andaj këtu po trego se je e pa aftë me e udhëheq mbledhjen e asamblesë ose thuaj se unë po veproj qysh po më konvenon madje kur të kërkojnë asamblistët fjalë ka raste kur kryetari të thotë jo e ti nuk e lejon , andaj mendoj se mos të bëhen më kësi veprime.

z. Ali Tafarshiku: Njëra nga ndërmarrjet me gjendjen më të keqen për raportet financiare dhe tabela janë të ngjashme dhe tani në fund të vitit e trajtojmë raportin e një viti më për gjë që nuk ka ndonjë efekt .

Në mbledhjen e KPF-së ka raportuar krye shefi ekzekutiv i cili ka shprehur gatishmëri për bashkëpunim me të gjitha ne gjë që nuk po vërehet edhe nga ju, dhe pyetja parë është se a i keni siguruar disa karrika për atë sall të mbledhjeve sepse është turp me shuku me e gjet sallën në atë gjendje a jeni në ngjarje që e vetmja ndërmarrje komunale që nuk ka pranua subvencion apo ndihmë institucionale në kohën e covidit është Stacioni i autobusëve, a keni heq dorë nga pretendimi për ndërtimin e banesave në Garazhen e Stacionit të autobusëve dhe a keni mëndur ndonjë ide më kreative për zhvillimin e garazhes së autobusëve. A keni filluar ndonjë planifikim për negociata me BERZH-in për renovimin e objektit të Stacionit të Autobusëve, për blerjen e autobusëve të ri do ta kishim mundësua funksionalizimin e transportit urban, si dhe a e keni shqyrtua mundësinë për shfrytëzimin e parkingjeve nga Stacioni Autobusëve në mënyrë që të krijoj të ardhura dhe të zhvillohet kjo ndërmarrje.

z. Agustin Shala: I vetmi raport që i plotëson standardet për nga forma e përpilimit të tiji ndërsa për nga përmbajtja shifrat që janë prezantuar po bie ndesh me njëra tjetrën psh. tek parimi i vijimësisë thuhet se biznesi është në gjendje të funksionoj sipas këtij parimi gjë që në shpalosjet e dokumenteve shihet se është e pa mundshme sepse pasurit qarkulluese janë dy herë më të vogla se shpenzimet afatshkurta , dhe rrjedhën e kemi negative tek investuesi rrjedha është negative , tek financuesi rrjedhën e kemi negative atëherë nuk po e shohim që kemi ndonjë perspektive në bazë të këtyre që janë prezantuar nuk ka burime të financimit që janë prezantuar këtu, edhe pse drejtori ekzekutiv na ka dhënë shumë shpresa se do ti tejkalojmë këto sfida .

z. Flamur Fetahaj: Unë e ceka edhe më herët se kjo ndërmarrje i ka vetëm dy burime të të hyrave dhe mundësia për ngritjen e të hyrave nga këto asete, por planifikimi për të hyrat e vitit 2022 e ka tejkaluar në 9 mujorin e parë dhe duhet të falënderojmë edhe inspektorët dhe Policin që na kanë asistuar që nisjet që janë bërë jashtë stacionit të hyjnë dhe të nisen nga Stacioni i autobusëve, sa i përket transparencës ne jemi shumë të hapur dhe nuk kemi pasur asnjë kërkesë për takime apo për ndonjë sqarime dhe nuk qëndron ajo që u tha nga z. Tafarshiku , për sa i përket karriqeve e të tjera për Sallën e mbledhjeve me këto mund të merret krye shefi , ndërsa për sa i përket Garazhës në ditët e ardhshme do të shohim se si do të veprojmë , Ndërmarrja ka të hyr a të vogla dhe po bëjmë përpjekje që të ekzistojmë dhe do të gjejmë mënyra që të krijojmë të hyra .

z. Ali Tafarshiku : Në fjalimin e juaj edhe të kryetarit e thatë se ligjërisht e kemi vetëm raportin financiar dhe për këtë thash se duhet të kemi të gjitha raportet dhe informatat e ndërmarrjes në mënyrë që të japim të gjitha kontributin tona dhe pyetja ime ishte se a e keni ndërrua idenë për Garazhen e Autobusëve dhe për parkingjet në asnjërin nuk kam marr përgjigjeje.

Kryesuesja: Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës .

13. Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës: Rishikimi i Vendimit 01 nr.011/01-21906 i datës 28.09.2022 për caktimin e Lokacionit për ndërtimin e Qendrës Ditore për Pensionistë në Komunën e Gjakovës

Kryesuesja: Për këtë vendim kemi marrë rekomandimin nga Ministria se duhet të rishqyrtohet për arsye se prona në të cilën është caktuar ndërtim i këtij objekti nuk është bartur ende në Pronësi të Komunës së Gjakovës andaj ne jemi të detyruar që të bëjmë anulimin e këtij vendimi .

Kryesuesja : E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës .

znj. Mimoza Shala : Kjo çështje është ka na përsëritet për çdo mbledhje dhe kjo i bijë se Zyra ligjore nuk është ka e kryen punën si duhet ose të mbahet një mbledhje vetëm për rishikime sepse kjo që po na ndodh definitivisht nuk është në rregull

z. Teki Shala : Në çdo mbledhje të Kuvendit po na rikthen vendimet e marra dhe kjo na len me kuptua se vërtetë qeveria komunale na bijën dokumente të pa vlerësuar mirë dhe kjo ndikon edhe në performancën e komunës sidomos tek aktet që kanë të bëjnë me pronën komunale andaj kërkoj nga ju kryesues që të bëhet kërkesë edhe për ekzekutivin e komunës që mos të na sjellën dokumente të tilla të pa shqyrtuara mirë .

Kryesuesja: E qes në Votim anulimin e Vendimit 01 nr.011/01-21906 i datës 28.09.2022 për caktimin e Lokacionit për ndërtimin e Qendrës Ditore për Pensionistë në Komunën e Gjakovës. **Kush Është Për , Kundër, Abstenim. Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit unanimisht u votua por , dhe pas votimit të bërë u miratua ky :**

V E N D I M

Për

Shfuqizimin

e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01 nr.011/01-21906 i datës 28.09.2022 .

1. Shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr.011/01-21906 i datës 28.09.2022 për caktimin e Lokacionit për ndërtimin e Qendrës Ditore për Pensionistë në Komunën e Gjakovës .
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

14. Pika e katërmëdhjetë e rendi të ditës : Rishikimi i Rregullores 01 nr.110/04-21913 e datës 28.09.2022 për Taksa komunale

Kryesuesja : Për këtë pikë e kemi Rishikimin e Rregullores 01 nr.110/04-21913 e datës 28.09.2022 për Taksa komunale ku nga Ministra e Shëndetësisë është rekomanduar që të hekën nga tabela disa nga pikat e bashkëfinancimit siç janë pika 8,14,24,27,28,29, i nenit 35 të kësaj rregullore andaj sipas rekomandimit të mstrisë ju kemi prezantuar sot për rishqyrtim dhe miratim të kësaj rregullore .

Kryesuesja : E hapi diskutimin për këtë pikë të reinit të ditës .

z.Ali Tafarshiku: Ka mundësi dikush me na sqarua pse është kthye kjo sepse nuk ka paqartësi por ka padituni, qe tri herë e njëjta pikë po kërkohet të rishqyrtohet a ka dikush që ta merr përgjegjësin dikush e të na sqaroj arsyen pse po ndodh kjo .

Kryesuesja: Ne jemi takuar edhe me zyrën Ligjore jemi takuar dhe kemi vënë kontakte edhe me përfaqësuesit e Ministrive përkatëse ka lëshime dhe mangësi edhe nga Ministrinë e linjës sepse na vijnë vlerësimet e ndryshme pa një koordinim, dhe e kemi caktuar edhe një takim me përfaqësuesit e MAPL-së pikërisht për këto çështje pra nuk është i gjitha faji tek ne sepse këta zyrtarët janë që kanë qenë qe sa vite meqenëse nuk ka diskutime të tjera E qes në Votim Rishikimin e Rregullores 01 nr.110/04-21913 e datës 28.09.2022 për Taksa komunale sipas rekomandimit të Ministrisë për Shëndetësi që të hekën nga tabela disa nga pikat e bashkëfinancimit siç janë pika 8,14,24,27,28,29, të nenit 35 të rregullores, **Kush Është Për, Kundër, Abstenim Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit unanimisht u votua por , dhe pas votimit të bërë u miratua kjo :**

**RREGULLORE
PËR TAKSA KOMUNALE**

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

15. Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës : Rishikimi i vendimit 01nr011/01-21911 i datës 30.09.2022 për mbështetje Financiare të Shoqatës Handikos .

Kryesuesja: Për këtë pikë e kemi Rishikimi i vendimit 01nr011/01-21911 i datës 30.09.2022 për mbështetje Financiare të Shoqatës Handikos , për arsye se ministra ka kërkuar që të shënohen kodet buxhetore ku do të merren mjetet në kategorinë për subvencione në Drejtorinë e Shëndetësisë për realizimin këtij vendimi , prezent e kemi drejtorin z. Durim Halilaj të cilin e ftoj që ta merr fjalën për sqarimin e kësaj procedure .

z. Durim Halilaj: Ne si ekzekutiv duhet të jemi të kujdesshëm sepse ministrinë janë duke u marrë me detaje interesante në këto kohë e fundit sepse e edhe për këtë vendim i cili është duke u rikthyer që dy herë pasi që Kuvendi ka marrë vendim Drejtoria e Shëndetësisë duke u bazuar në at vendim ka marr veprime dhe i ka zotuar mjetet dhe ministria e shëndetësi i ka shikuar mjetet dhe nuk i ka parë mjetet e lira të cilat kanë qenë të zotuar menjëherë ka kthyer vendimin si të kundërligjshëm se nuk ka mjete të lira dhe ju kemi dërguar se mjetet janë dhe janë të zotuar kanë thënë se duhet të rishikoni sepse kemi marr vendim .

z. Ali Tafarshiku: Sipas jush fajet i kanë ministria apo qysh mundet mos me i shikua hollësitë dhe nëse jeni mësua me ju aprovuar në shabllon inkurajoj me i kthye edhe të tjera kur ne të padijshmit i votojmë, kur janë zotuar mjetet pa e ditë a po e miraton kuvendi vendimi apo jo, e nëse janë zotuar pa u kthye vendimi prapa jeni gabim ju .

z. Durim Halilaj: Ne duhet të jemi më të kujdesshëm për të gjitha vendimet, në momentin kur kuvendi merr vendim ne si drejtori jemi të obliguar që ti sigurojmë mjetet 15 ditë kanë kalua dhe ne me dt. 07.10 i kemi zotuar mjetet dhe ministria pas një muaj thotë se nuk i ke mjetet e lira kjo është çështja dhe pasi ja kemi dërguar dokumenti thonë se tani e kemi anulua .

Kryesuesja: E qes në Votim Rishikimi i vendimit 01nr011/01-21911 i datës 30.09.2022 për mbështetje Financiare të Shoqatës Handikos sipas rekomandimit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Kush Është Për , Kundër, Abstenim. Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit unanimisht u votua por , dhe pas votimit të bërë u miratua ky :

V E N D I M

Për

mbështetje financiare të shoqatës “Handikos Gjakovë”

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës “Handikos Gjakovë” për mbështetje financiare në vlerë prej 20.000€ me qëllim të përkrahjes për realizimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara që ofrohen nga “Handikos Gjakovë” .

2. Mjetet financiare në vlerë prej 20.000€ për Shoqatën “Handikos Gjakovë” ndahen nga Kategoria e Subvencioneve Komunale të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenieje Sociale në këtë kod 21/632/73950/200/00000/0721 dhe në kodin 22/632/73950/200//00000/0721 Drejtoria e Shëndetësisë.

3. Obligohen organet e Administratës Komunale për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet ligjore në fuqi, për ekzekutimin e mjeteve financiare sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi .

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

16. Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës : Të Ndryshme


Kryesuesja: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi të ndryshme dhe kërkoj që ta respektoni në përpikëri rregullorja e Punës së Kuvendit , E hapi diskutimin për këtë pikë .

znj. Mimoza Shala: Një vërejtje për kolegët asamblistë që kanë dalë dhe ka që janë nënshkruar pra pauzës dhe kjo nuk është në rregull , dhe tjetra unë po dëshiroj që të ju bëj ftesë vajzave dhe grave në Komunën e Gjakovës që të marrin pjesë në zgjedhjet e këshillave lokal sepse kuota gjinore nuk është e përmbushur .

Kryesuesja : Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur diskutimin për këtë pikë të rendi të ditës

Mbledhja përfundoj në ora 16:20

Procesmbajtës


Burim Bajrami



Arbënesha Kuqi


Kryesuesja e Kuvendit